



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në seancën e 50-të, të mbajtur më datë 22.04.2021 morri

## VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12 - 707 të vitit 2021, e formuar pas denoncimit me numër 12 - 707/1 nga data 15.02.2021, e dorëzuar nga parashtruesi „-----“ SHPKNJP nga -----, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka elemente për veprimin e tij të mëtëjshëm kompetent në lëndën me numër 12 - 707 e vitit 2021, në rastin e lëndës nga parashtruesi plotësisht është tërhequr denoncimi i dorëzuar.

Lënda me numër 12 -707 e vitit 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK -së, me arsyetim.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Lënda me numër 12 - 707 të vitit 2021, e formuar pas denoncimit/ njoftimit me numër 12 - 707/1 të datës 15.02.2021, e dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) nga parashtrues i njohur, „-----“ SHPKNJP nga -----,.

Në denoncimin/njoftimin e marrë raportohet për aktivitete kriminale në Bankën Eurostandard në falimentim dhe në të njëjten jan paraqit pohime për dyshim në procedurën e falimentimit në lidhje me veprimet e Gjykatës të Falimentimit ----- dhe Administratorit të falimentimit -----, sepse gjatë kryerjes së procedurës së falimentimit mbi bankën e deklaruar, këta dy persona bashkëpunuan për përfitimin e tyre dhe në të njëjtën kohë shkaktuan dëme të mëdha të gjithë klientëve të Bankës Eurostandard në falimentim.

Parashtruesi i denoncimit, njoftimin e lëndës me numrin e tyre ----- të datës 12.02.2021 e dorëzon në KSHPK si një nga klientët e Bankës Eurostandard tani në falimentim, i cili ishte përfitues i një kredie që rregullisht ata e kishin shërbyer atë deri në ditën e hapjes së falimentimit dhe ishte në kategorinë

A gjatë gjithë kohës, dhe si person juridik u bë objekt i shantazhit nga personi -----, burri i gjyqtarit të mësipërm të falimentimit. Përndryshe, parashtruesi deklaroi se në kohën kur u hap procedura e Falimentimit, ky person në disa raste i bindi klientët të bashkëpunonin me të me një premtime që nga Administratori i Falimentimit -----, do të marrin privilegje të caktuara dhe atë shpërblim të duhur, të cilat ishin në dëm të klientëve dhe në favor të tyre. Sipas parashtruesit, Gjykatësja e Falimentimit -----, duhet të ishte përjashtuar nga çështja në fjalë sepse burri i saj ishte pronar dhe menaxher i disa ndërmarrjeve dhe atë, ----- dhe për shkak se disa prej kompanive kishin kredi dhe depozita në Bankën Eurostandard tani në falimentim, kështu që sipas parashtruesit këtu kishte dyshim për një konflikt të vërtetë interesi, dhe në të njëjtën kohë Administratori i Falimentimit ----- ishte njohur tashmë me kompanitë e burrit të gjyqtaresë, ku kishte qenë Administruesi i Falimentimit në ato procedura më parë. Më në fund, parashtruesi kërkon, që të ndërmerren veprime për të ndryshuar Gjykatësin e Falimentimit dhe Administratorin e Falimentimit të Bankës Eurostandard në falimentim.

Nga ana e parashtruesit në njoftim është vendosur shkres me numrin e tyre 03-102 / 21 të datës 29.03.2021, e cila është regjistruar në arkivat e KSHPK -së nën numrin 12-707 / 2 të datës 01.04.2021, dhe me të cilën parashtruesi informon KSHPK - në që e tërheq plotësisht njoftimin e dorëzuar në KSHPK me datë 12.02. të vitit 2021.

Në seancë, pas shqyrtimit të pohime në lëndën e denoncuar, KSHPK konstaton se në lëndën e rastit nga ana e parashtruesit u tërhoqë plotësisht njoftimi i dorëzuar, pas së cilës Komisioni Shtetëror vlerësoi se nuk ka elemente për veprimin e tij të mëtejshëm kompetent në lëndën e rastit, procedura sipas lëndës së formuar pas denoncimit të dorëzuar ndërpritet, lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasur parasysh të theksuaren e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

KOMISIONI SHETETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Kryetar,  
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te: Arkivi  
Parashtruesi  
Punoi: J.C.  
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së